



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 238, datë 20.4.2022

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT TË INSTITUTIT TË POLICISË
SHKENCORE DHE CAKTIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
TË POLICISË SË SHETIT SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.117/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore, në masën 653 582 498 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme, në programin buxhetor “Policia e Shtetit” 03440, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, shtohet fondi prej 130 716 500 (njëqind e tridhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit caktohet si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objektit të Institutit të Policisë Shkencore.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 2244/I
DATE 21.4. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË
SHTETIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

